



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr. 151, datë 06.05.2020

**PËR
FILLIMIN E PROCEDURËSË VERIFIKIMIT TË KRITEREVE LIGJORE
TË KANDIDIMIT PËR GJYQTAR NË GJYKATËN E LARTË, PËR KANDIDATËT
NGA RADHËT E GJYQTARËVE, PËR POZICIONET E LIRA TË SHPALLURA ME
VENDIMIN NR.82, DATË 26.02.2020 DHE VENDIMIN NR.85, DATË 26.02.2020,
TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 136 dhe 147/a, pika 1, shkronjat “c” dhe “ë”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 85, pikat 2 e 3 dhe nenin 86, shkronjat “ç” dhe “ë”, të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 48, pika 7, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në Kreun V, Seksioni A, pika 1, shkronja “c” dhe pika 2, si dhe në Kreun VI, Seksioni B, pika 7, të Vendimit të tij nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, pas shortit të hedhur,

VENDOSI:

I. Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për kandidatët nga radhët e gjyqtarëve që kanë aplikuar për pozicionet e lira të shpallura me Vendimin nr.82, datë 26.02.2020 (në fushën e të drejtës administrative) dhe me Vendimin nr.85, datë 26.02.2020 (në fushën e të drejtës civile), të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

II. Caktimin e relatorit për secilin kandidat, si mëposhtë:

- | | |
|-----------------------------------------|-------------------------------|
| 1. Për kandidaten znj. Albana Boksi | - relator z. Alban Toro. |
| 2. Për kandidaten znj. Alma Hicka | - relator z. Alban Toro. |
| 3. Për kandidatin z. Gentian Medja | - relator z. Ilir Toska. |
| 4. Për kandidatin z. Dhimitër Lara | - relator znj. Marçela Shehu. |
| 5. Për kandidatin z. Klodian Kurushi | - relator znj. Marçela Shehu. |
| 6. Për kandidaten znj. Klodiana Veizi | - relator z. Alban Toro. |
| 7. Për kandidaten znj. Margarita Buhali | - relator znj. Marçela Shehu. |
| 8. Për kandidaten znj. Manjola Xhaxho | - relator z. Ilir Toska. |
| 9. Për kandidaten znj. Saida Dollani | - relator z. Alban Toro. |
| 10. Për kandidatin z. Sokol Ngresi | - relator z. Ilir Toska. |
| 11. Për kandidatin z. Sokol Ibi | - relator znj. Marçela Shehu. |

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR